



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 8, paragrafi 1, pika 1.2, e konform nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.07.2022, miraton këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**z. Agron TELAK** me numër personal të letërnjoftimit **1172111218** nga **Prizreni Rr. “Nuriye Shala” p.n; Ljepet** në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite, prona e paluajtshme, pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, konkretisht parcela, **Nr-313/26**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=14092m<sup>2</sup>** dhe parcela, **Nr-313/27**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=7896m<sup>2</sup>** me destinim sipas planit rregullativ në **“Agro zona industriale”** në Samadraxhë **për ushtrim të veprimtarisë afariste, “Prodhimi i mishit-viçit, pulës dhe peshkut”**, sipas rekomandimit 01-Nr-052-32571 të datës 09.06.2021, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës fillon të rrjedh nga data, **21.07.2022**, dhe përfundon afati më datën, **20.07.2121**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

### Neni 3

**3.1 Obligohet;** Kryetari i Komunës që me **personat fizik përfitues të pronës së paluajtshme të cekur më lartë**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

**3.2. Obligohen;** përfituesit e pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personat fizikë të cekur në neni 1, të këtij vendim, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendim të sjellin garancioni bankar ose sigurimin nga kompanit e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

**3.3** Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.



#### Neni 4

4.1 **Obligohen** shfrytëzuesit e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

#### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

### KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr- 016-44152  
Më datë 21.07.2022



Kryesuesi i Kuvendit  
*[Signature]*  
Mr. ec Bexhet KUÇI

